



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1870/ 8 prot.

Datë 13.09.2023

V E N D I M
Nr. 901/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.09.2023, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 1870 prot., më datë 31.07.2023, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje Kuadër - prokurim publik me mjete elektronike*” me Nr. REF-69560-05-17-2023, me objekt “*Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq - Delvinë, Loti - 7 (Tuneli)*”, me fond limit 86,870,520 (*tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet*) lekë pa TVSH ose 773,006.94 (*shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e katër*) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 21.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK me NIPT K91628013D, me adresë rruga “*Asim Vokshi*”, Pallati Alb Building, kt. 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: Rruga “*Sami Frashëri*”, Nr. 33, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I*****Vlerësimi paraprak***

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1. Në datën 19.05.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje Kuadër - prokurim publik me mjete elektronike” me Nr. REF-69560-05-17-2023, me objekt “Mirëmbajtja

e rrugës Kardhiq - Delvinë, Loti - 7 (Tuneli)”, me fond limit 86,870,520 (tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH ose 773,006.94 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e katër) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 21.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datë 21.06.2023 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 12.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “HTM” SHPK	74.715.100	lekë	skualifikuar
2. “Salillari” SHPK	80.709.000	lekë	kualifikuar
3. “Alko Impex Konstruksion” SHPK	82.508.000	lekë	kualifikuar
4. “Iliriada” SHPK	85.205.000	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 21.07.2023 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 31.07.2023, operatori ekonomik ankimues “Alko Impex Konstruksion” SHPK, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor ankesën nr. 1870 prot, datë 31.07.2023 nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Salillari” SHPK me përmbajtje si më poshtë vijon:

[...] Duke marrë në konsideratë kriteret kualifikuese të parashikuara në dokumentet standarde, ligjin përkatës dhe kapacitet teknike të shoqërisë Salillari ShPK, çmujmë se oferta e kësaj shoqërie duhet të ishte skualifikuar në kushtet kur nuk përmbush disa prej kriterëve të parashikuara në DST si më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve / punimeve objekt-kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e transportit)
- 1 (një) Inxhinier Mekanik / Elektrik / Elektronik

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtimesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

** Stafi teknik i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.*

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e shërbimeve / punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Mekanik

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Elektronik

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

** Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.*
- 1 (një) ekspert zjarrfikës me certifikatën përkatëse lëshuar nga Drejtoria e MZSH-së / licencë për mbrojtje nga zjarri të lëshuar nga QKL, Kodi I.2.A.*

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.6 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Ka rezultuar se në plotësim të këtij kriteri fillimisht nga ana e OE SALILLARI ShPK është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit e më pas pas kryerjes së Njoftimit paraprak të Fituesit është dorëzuar dhe dokumentacioni fizik, ku një pjesë e tyre janë dhe të dhënat dhe dokumentet në plotësim të kriterëve 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.6 të DST. Por si në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria SALILLART ShPK, rezultoi se stafi mësipërm i këtij operatori ekonomik është i deklaruar në kontrata të tjera ku ky operator ekonomik është shpallur fitues, e për më tepër një pjesë e mirë e tyre i deklaruar në kontrata në të cilat ky operator ekonomik është shpallur fitues pranë vet Autoritetit Kontraktor.

Më konkretisht, kontratat:

1- “Mbrojtje lumore nga km 9+040 deri në km 9+240 në aksin Milot Morinë”

2- Minikontrata 1 Loti 4: Kontrata D “Mirëmbajtje me performance e akseve kryesore të Rajonit Jugor”

3- Minikontrata 1 Loti 4; Kontrata D “Mirëmbajtje me performance e akseve kryesore të Rajonit Jugor”

4- Loti 4: Kontrata D “Mirëmbajtje me performance e akseve kryesore të Rajonit Jugor”

5- Plotësimi rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja - Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT”

6- Shtesë kontrate - Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi pallati me shigjeta — rrethrotullimi Shqiponja, Loti 2,

7- Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja Loti

8- Minikontrata nr. 1 në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me titull: Mirëmbajtje me performance të rrugëve Rajoni Verior - Loti VI: “Mirëmbajtje rutinë me performance rruga "Ura e Zogut - Rreshen (Ura e Fanit), Ura e Matit (e trenit) - Ura e Zogut, K/Pllane-

U.Zogut, Ura e Matit (E trenit)- Nyja Milot”

9- Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Verior - Loti VI: “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "Ura e Zogut -Rreshen (Ura e Fanit), Ura e Matit (e trenit) - Ura e Zogut, K/Pllane-U.Zogut, Ura e Matit (E trenit)- Nyja Milot”

10- Ndërtim, përmirësim, operim (duke përfshirë vjeljen e taksave të rrugës) dhe mirëmbajtja e autostradës Milot - Morinë) KONCESION.

Për sa më sipër, mjaftuar vetëm me procedurat e prokurimit në të cilat ky operator ekonomik është shpallur fitues pranë AK-së dhe angazhimit të stafit të tij pranë këtij autoriteti kontraktor në këto procedura duhet të kishin çuar në skualifikimin e ofertës së tij, si një ofertë e cila bie ndesh me kriteret kualifikuese të parashikuara nga ana e autoritetit kontraktor.

Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efincencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe Jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik;

Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në.: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare, c) aftësinë teknike dhe profesionale...[

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti Kontraktor duhet të verifikojë dhe vlerësojë ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që operatorët ekonomikë ofertues për shërbimin objekt-prokurimi stafi i deklaruar nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera të shpallura fitues. Por nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “Salillari”

ShPK nuk plotësohet kriteri i parashikuar nga AK në DST, pasi rezulton se stafi teknik i deklaruar është i angazhuar në kontrata të tjera.

Si rrjedhojë përfundimisht kërkojmë:

1. Shfuqizimin e vendimit të KVO për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “Salillari” ShPK...[...]

II.6. Bazuar në nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1870/2 prot., datë 01.08.2023, u publikuan kriteret e kualifikimit të cilat operatori ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 1870/3 prot, datë 07.08.2023, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK, Formulari i Paraqitjes së Argumenteve nga Operatori Ekonomik i Interesuar “Salillari” SHPK, si subjekt që i preken interesat nga ankesa e bërë nga operatori ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 6453/3 prot., datë 03.08.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1870/4 prot, datë 08.08.2023, është depozituar informacioni i autoritetit kontraktor, si dhe kthim-përgjigjja e operatorit ekonomik ankimes lidhur me trajtimin e ankesës së tij, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur mospranimin e ankesës me përmbajtje si më poshtë vijon:

[.....]

III. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë ankesë komisioni i shqyrtimit të ankesave vëren se:

Operatori ekonomik “Salillari” ShPK., ka në proces zbatimi me Autoritetin Rrugor Shqiptar vetëm kontratat si më poshtë:

1- “Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja-Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT”

2- “Mbrotjtje lumore nga km 9+040 deri në km 9+240 në aksin Milot Morinë

3- Loti 4: Kontrata D “Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Jugor”

4- Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Verior - Loti VI : “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga “Ura e Zogut - Rrëshen (Ura e Fanit), Ura e Matit (e trenit)- Ura e Zogut, K/Pllane -U.Zogut, Ura e Matit (e trenit) — Nyja Milot”.

Nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave është evidentuar stafi i angazhuar në të gjithë kontratat aktive të sipërpërmëndura dhe nuk rezulton që stafi i deklaruar në procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e rrugës Kardhiq- Delvinë, Loti 7 (Tuneli) të jetë i angazhuar në këto kontrata.

Për sa i përket kontratës “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Autostradës Milot-Morinë”, operatori ekonomik “Salillari” ShPK, si nënkontraktor i punimeve në këtë kontratë ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi si punë të ngjashme të gjithë elementët e nevojshëm (formular vlerësimi nga Autoriteti Kontraktor, vërtetime, situacione, fatura etj.) për të cilën operatori e ka përfunduar me sukses në Dhjetor 2022. Për rrjedhojë edhe stafi i deklaruar në këtë procedure nga Salillari ShPK., rezulton se e ka përfunduar angazhimin në kontratën Konkensionare.

Për sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës mbas shqyrtimit të dokumentacionit, gjykon se pretendimi juaj nuk qëndron.

IV. Vendimi i komisionit të shqyrtimit të ankesës:

Komisioni i shqyrtimit të ankesës vendosi të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Konstruktion” ShPK për procedurën me objekt “Mirëmbajtje e rrugës Kardhiq Delvinë, Loti 7 (tuneli)”, me fond limit 86,870,520 (tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet) Lekë pa TVSh, me REF-64347-03-30-2023.[..]

II.9. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, me anë të shkresës nr. 1870/5 prot., datë 29.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion të detajuar mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi në përputhje me nenin 114 të LPP-së.

II.10. Me anë të shkresës Nr. 6940/1 prot., datë 31.08.2023, protokolluar me tonë me nr. 1870/6 prot., datë 04.09.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin në lidhje me procedurën e prokurimit së bashku me CD.

II.11. Me shkresën me objekt “Heqje dorë nga shqyrtimi i ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq – Delvinë, Loti 7 (Tuneli)”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me shkresën nr. 1870/7 prot., datë 13.09.2023, operatori ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë për tërheqjen nga ankesa për procedurën e mësipërme të prokurimit. Në kërkesën e mësipërme operatori ekonomik ankimues citon: “Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa e paraqitur nga shoqëria Alko Impex Construction me palë dhe objekt si më poshtë, Autoritet Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar, Objekti i Procedurës: Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq – Delvinë, Loti 7 (Tuneli)”. Bazuar në paragrafin e parë të nenit 117 të LPP-së, deklaroj dhe kërkoj Heqjen dorë nga shqyrtimi i ankesës të paraqitura si më sipër cituar”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “*Alko Impex Construction*” SHPK protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 1870/7 prot, datë 13.09.2023, me objekt heqje dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje Kuadër - prokurim publik me mjete elektronike*” me Nr. REF-69560-05-17-2023, me objekt “*Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq - Delvinë, Loti - 7 (Tuneli)*”, me fond limit 86,870,520 (*tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet*) lekë pa TVSH ose 773,006.94 (*shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e katër*) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 21.06.2023, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar parashikimeve të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” ku përcaktohet, se “*1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankesë dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. 2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.*” dhe parashikimeve të nenit 105 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt-ankimimin e tij, dhe si pasojë mosshqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë vetë ankimuesi shpreh vullnetin e tij të lirë për t’u tërhequr nga ankesa, të cilën ligjvënësi e ka përcaktuar si një mjet ligjor për t’i ardhur në ndihmë operatorëve ekonomikë të cilëve u janë prekur ose mund t’i preken interesat nga vendimet e autoritetit kontraktor, dhe për sa kohë që ankimuesi nuk shfaq më interes për procedurën e prokurimit në bazë të kërkesës së bërë, atëherë ankesa e bërë prej tij e humbet qëllimin e saj si një mjet ligjor nëpërmjet të cilit operatorët ekonomikë mund të realizonin qëllimin e tyre, për t’u shpallur fitues një procedurë

prokurimi. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 1870 prot, datë 31.07.2023, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për ankesën e operatorit ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje Kuadër - prokurim publik me mjete elektronike*” me Nr. REF-69560-05-17-2023, me objekt “*Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq - Delvinë, Loti - 7 (Tuneli)*”, me fond limit 86,870,520 (*tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet*) lekë pa TVSH ose 773,006.94 (*shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e katër*) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 21.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri